



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 2 Mars 2022

Nr: 116

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR PËR DHËNIE AUTORIZIMI  
PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT, PËR  
ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit nr. 13438, datë 20.1.2022, të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, neneve 19, pika 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, pika 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Neni 62, pika 4, e Kodit Zgjedhor përcakton se vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit, me përjashtim të rastit kur për arsye objektive apo të parashikuara në nenin 93, kjo nuk është e mundur. Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur, për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja.

Kryetari i Bashkisë Shkodër me shkresat nr. 1180-1181 prot., datë 24.2.2022, ka paraqitur kërkesat për ndryshimin e 12 (njëmbëdhjetë) qendrave të votimit të njërive administrative Shalë, Shosh dhe Pult.

Përkatësisht Bashkia Shkodër ka kërkuar:

- QV 0115, 0116, 0117, 0118, 0119 dhe 0119/1 që ndodhen në njësinë administrative Shalë, të transferohen në lagjia “Fermentim”, njësia administrative Rrethina, në një ambjent privat;
- QV 0132 dhe 0133 që ndodhen në njësinë administrative Shosh, të transferohen po në lagjen Fermentim, njësia administrative Rrethina, në një ambjent privat;



- QV 0091, 0092, 0093 dhe 0094 në njësinë administrative Pult, të transferohen në njësinë administrative Rrethina në një ambient privat.

Bashkia Shkodër argumenton se asnjë nga QV-të e sipërpërmendura nuk garantojnë kushte të përshtatshme të tilla si, izolim nga lagështira, nuk disponojnë rrymë elektrike, ujë të pijshëm, etj. Argumentimi i bashkisë për kushtet e vështira të këtyre qendrave të votimit lidhet me kushtet atmosferike (zonë më ngricë dhe dëborë), mungesë e energjisë elektrike, ambiente të amortizuara, rrugë me vështirësi në akses apo pamundësi në disa vende.

Me shkresën nr. 3288 prot., datë 28.2.2022, parashtrohet se numri i zgjedhësve që dimërojnë në këto zona është jo më shumë se 220 vetë, dhe se në këto zona malore nuk ka asnjë ambient publik dhe është propozuar që QV-të të vendosen në njësinë administrative Rrethina si njësi më e afërt me këto qendra, duke marrë në konsideratë që banorët e këtyre fshtarave banojnë në dimër kryesisht në këtë njësi administrative. Për sa më sipër, bashkia Shkodër deklaron se është e pamundur që këto QV të bëhen funksionale për zgjedhjet e datës 6 Mars 2022.

Neni 62, pika 4, e Kodit Zgjedhor, përcakton kriteret e caktimit të vendodhjes së Qendrës së Votimit, ndërsa neni 93, pika 3, e Kodit Zgjedhor, përcakton kushtet për caktimin e QV-ve në ambiente private. Sipas kësaj dispozite, KQZ-ja mund të caktojë qendra votimi në ndërtesa private kur nuk ka mundësi objektive për të përdorur një ndërtesë publike në zonën e qendrës së votimit ose në një zonë qendre votimi fqinje.

Nga sa referuar më sipër vërehet se, Kodi Zgjedhor nuk lejon autorizimin e transferimit të vendndodhjes së QV-së në një ambient privat në një njësi tjetër administrative por në një zonë qendre votimi fqinje. Në kuptim të nenit 62, pika 1, e Kodit Zgjedhor, zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt dhe të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk duhet të jetë më i vogël se 300 (treqind) dhe më i madh se 1,000 (një mijë) zgjedhës.

Bashkia Shkodër nuk ka paraqitur propozim për objekte në zonën e qendrës fqinje të votimit por në njësi administrative fqinje, kërkesë që bie ndesh më pikën 4, të nenit 93, të Kodit Zgjedhor.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në nenin 19, pika 2, nenin 62, pika 4, nenin 93 pikat 2 dhe 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 3, të udhëzimit nr.1, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjes së hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”,



## VENDOSI:

1. Refuzimin e dhënies së autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së qendrave të votimit nr. 0115, 0116, 0117, 0118, 0119, 0119/1, 0132, 0133, 0091, 0092, 0093 dhe 0094, kërkuar nga Bashkia Shkodër.
2. T'i kërkojë Autoritetit Rrugor Shtetëror dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, marrjen e masave për sigurimin e aksesit të rrugëve dhe energjisë elektrike në zonat e qendrave të votimit në njësitë administrative Shosh, Pult dhe Shalë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

